



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. ____ prot

Durrës, më 04. 05. 2020

VENDIM

Nr. 54, datë 04.05.2020

Në mbështetje të ligjit nr. 80|2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë”, të vendimit të këshillit të ministrave nr.658, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të statutit dhe rregullores së Universitetit Aleksandër Moisiu dhe urdhërit të Ministrit të Arsimit, Rinisë dhe Sporteve nr. 104, datë 30.4.2020 për “Marrjen e masave për mbylljen e vitit akademi 2019-2020 nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjëndjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID 19”, vendimit të Rektoratit nr.7, datë 01.05.2020, Senati Akademi,

VENDOSI:

1. Të marrë masat për rikthimin në auditorë me datë 1 Qershor 2020, të studentëve të të gjithë cikleve të studimit që diplomohen në vitin akademik 2019-2020, për përsëritjen e leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike.
2. Të miratojë ndryshimet në kalendarin akademik 2019-2020 si më poshtë:
 - 1 Qershor-21 Qershor, realizimi i përsëritjeve të leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike për studentët e vitit të tretë të ciklit të studimeve bachelor dhe për studentët e vitit të fundit të ciklit të studimeve master.
 - 22 Qershor-28 Qershor, java e përgatitjes për provimet përfundimtare.
 - 29 Qershor-12 Korrik. sezoni i provimeve.
 - 13 Korrik-19 Korrik, zhvillimi i provimeve të mbartura.
 - 20 Korrik-26 Korrik, mbrojtja e temave të diplomave/zhvillimi i provimit të formimit.
 - 27 Korrik-6 Gusht, përmbyllja e dokumentacionit për diplomim për studentët e vitit të tretë të ciklit të studimeve bachelor dhe për studentët e vitit të fundit të ciklit të studimeve master.

1 Shtator-28 Shtator, realizimi i përsëritjeve të leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike për studentët e vitit të parë dhe të dytë të ciklit të studimeve bachelor dhe për studentët e vitit të parë të ciklit të studimeve master.

22 Shtator-4 Tetor, java e përgatitjes për provimet përfundimtare.

5 Tetor-18 Tetor, sezoni i provimeve.

19 Tetor-25 Tetor, zhvillimi i provimeve të mbartura.

26 Tetor-1 Nëntor, përmbyllja e dokumentacionit.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:

- Administratori i UAMD
- Zv. Rektorët
- Dekanët e fakulteteve
- Drejtorët e drejtorive

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

